Europa League/ Laçi - Inter Baku 1-1

nga AlbaniaSoccer
E premte, 03 Korrik 2015 22:54

Laçi ka zhvilluar nje takim te mire ndaj skuadres Azerbajxhanase, por nuk ka mundur te shkoje me shume se barazimi. Ndonese krijoi epersi dhe raste me shume se skuadra mike, futbollistet e Laçit nuk ishin ne gjendje qe te arrinin nje fitore e cila do ti ndihmonte se tepermi ne rrugen kualifikuese per ne turin e dyte te Europa League. Ndonese shenoi me ane te Metos ne minuten e 20-te, djemte e Cungut nuk ishin ne gjendje qe te ruanin rezultatin, pasi Azeret, arriten te barazonin ne pjesen e dyte pas nje goli te shenuar nga goditja e denimit e shoqeruar edhe nga nje gabim fatal ne vendosje te murit dhe portierit Vujadinovic. Ky eshte nje rezultat aspak favorizues per Kukesin ndonese shpresat per nje kualifikim te mundshem vazhdojne. Takimi i kthimit do te zhvillohet ne Baku diten e enjte.